

## DISCOL, shërbimi i regjistrimit në shkollë për nxënësit e huaj

### Të dish

- Është e detyrueshme të shkosh në shkollë nga mosha **6 deri në 16 vjeç**
- Regjistrimi është i mundur **në çdo kohë të vitit**
- Nxënësi regjistrohet në shkollën publike edhe **pa dokumente dhe pa kod tatimor (Codice Fiscale)**
- Edhe nëse nuk di italisht, nxënësi duhet të regjistrohet **në klasën që i përket moshës së tij**
- Nxënësi që arrin në Itali në moshën 14 vjeç regjistrohet në shkollën e mesme, **edhe pa marrë diplomën e klasës së nënte**

### Nëse shkolla refuzon të regjistrimin?

#### Mesazh për prindin dhe vullnetarin

Një vullnetar do t'ju ndihmojë të gjeni një vend në shkollën publike. Shkruani të dhënat në: [info@scuolemigranti.org](mailto:info@scuolemigranti.org)

- emri dhe mbiemri i nxënësit
- viti i lindjes
- nënshtetësia
- adresa ku banon nxënësi
- emër, mbiemër dhe numër telefoni te prindërit
- emri i shkollës që ka refuzuar regjistrimin